

PARTIA E PUNËS E SHQIPËRISE
BYROJA POLITIKE E KOMITETIT QENDOR

TEPËR SEKRET

Nr. 000036

PLATFORMA
E
PUNËS OPERATIVE
E ORGANEVE TË PUNËVE
TË BRENDSHME

Tiranë, 1985

PARTIA E PUNËS E SHQIPËRISË
BYROJA POLITIKE E KOMITETIT QENDROR

TEPËR SEKRET

Nr. 000036

PLATFORMA
E
PUNËS OPERATIVE
E ORGANEVE TË PUNËVE TË BRENDSHME

(Miratuar në mbledhjen e Byrosë Politike
të Komitetit Qendror të PPSH datë 12.2.1985)

Tiranë, 1985

Partia e Punës e Shqipërisë
Bashkia Politike e Komitetit Qendror

TEPËR SEKRET

№ 00000

PLATFORMA
E
PUNËS OPERATIVE
E ORGANIT TË PUNËVE TË BRENDSHME

Organet e punëve të brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë janë një armë e fuqishme e diktaturës së proletariatit, një repart politik dhe ushtarak i saj që udhëhiqen nga Partia e Punës e Shqipërisë për të zbuluar dhe shpartalluar veprimtarinë armiqsore dhe keqbërëse të armiqve të brendshëm e të jashtëm, për të mbrojtur fitoret e revolucionit e atdheun socialist, për të garantuar triumfin e çështjes së komunizmit.

Organet e punëve të brendshme kanë detyra themelore: mbrojtjen dhe sigurimin e paprekshmërisë së kufijve të atdheut; sigurimin e jetës të udhëheqësve të Partisë e të shtetit; zbulimin, parandalimin, dokumentimin e goditjen në kohë të veprimtarisë armiqsore e keqbërëse; ruajtjen e Forcave të Armatosura nga veprimtaria armiqsore e keqbërëse; mbrojtjen e ekonomisë socialiste nga çdo veprimtari armiqsore e keqbërëse; sigurimin e rendit e të qetësisë, mbrojtjen e jetës e të interesave të qytetarëve.

I

Organet e punëve të brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë janë një armë e fuqishme e diktaturës së proletariatit, një repart politik dhe ushtarak i saj që udhëhiqen nga Partia e Punës e Shqipërisë për të zbuluar dhe shpartalluar veprimtarinë armiqsore dhe keqbërëse të armiqve të brendshëm e të jashtëm, për të mbrojtur fitoret e revolucionit e atdheun socialist, për të garantuar triumfin e çështjes së komunizmit.

Organet e punëve të brendshme kanë detyra themelore: mbrojtjen dhe sigurimin e paprekshmërisë së kufijve të atdheut; sigurimin e jetës të udhëheqësve të Partisë e të shtetit; zbulimin, parandalimin, dokumentimin e goditjen në kohë të veprimtarisë armiqsore e keqbërëse; ruajtjen e Forcave të Armatosura nga veprimtaria armiqsore e keqbërëse; mbrojtjen e ekonomisë socialiste nga çdo veprimtari armiqsore e keqbërëse; sigurimin e rendit e të qetësisë, mbrojtjen e jetës e të interesave të qytetarëve.

Në tërë veprimtarinë e tyre organet e punëve të brendshme udhëhiqen nga politika dhe ideologjia e Partisë së Punës të Shqipërisë, bazohen në Kushtetutën e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe në ligjshmërinë socialiste, ato mbështeten fuqimisht te populli.

Organet e punëve të brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë janë një grup i udhëheqja e vazhdueshme e kontrolli i plotë, i gjithanshëm dhe i pandarë i Partisë në organet e punëve të brendshme realizohet nëpërmjet drejtimit drejtpërdrejt të organizatave-bazë, të komiteteve e byrove të Partisë në organe e reparte, të komiteteve të Partisë në rrethe, në reparte e njësi të ushtrisë dhe të Komitetit Qendror të Partisë.

Organizata-bazë, komiteti ose byroja e Partisë në organet e punëve të brendshme udhëheqin dhe kontrollojnë qëndrimin dhe veprimtarinë e gjithë komunistëve dhe punonjësve të këtyre organeve. Ato shqyrtojnë çdo problem të punës të sektorëve të ndryshëm; përcaktojnë detyra e masa për forcimin e punës dhe aktivizimin e komunistëve dhe të gjithë punonjësve. Në raste të domosdoshme ekspozimi i emrave të përpunimeve dhe të bashkëpunëtorëve në organizatën-bazë të Partisë bëhet kurdoherë me miratim të sekretarit

të komitetit ose të byrosë së Partisë të degës së punëve të brendshme.

No -
deje
Për sekretarin e komitetit ose të byrosë së Partisë të organit të punëve të brendshme nuk ka asnjë kufizim konspiracioni të punës operative.

Byrotë dhe komitetet e Partisë të rretheve analizojnë punën e organeve të punëve të brendshme dhe bëjnë vlerësimin e veprimtarisë së këtyre organeve lidhur me zbatimin e vijës e të direktivave të Partisë për zbulimin, parandalimin dhe goditjen në kohë të veprimtarisë armiqsore e keqbërëse në rreth, për sigurimin dhe ruajtjen e kufirit, për politikën e goditjes, për sjelljet e marrëdhëniet e punonjësve me popullin etj. Në këto analiza ruhet konspiracioni për çështjet e agjunkturës, përpunimeve dhe formave e metodave të punës operative.

me
Për sekretarin e parë të komitetit të Partisë të rrethit nuk ka asnjë kufizim konspiracioni të punës operative të organeve të punëve të brendshme. Kryetari i degës të punëve të brendshme në rreth informon rregullisht sekretarin e parë të komitetit të Partisë të rrethit dhe, kur ky mungon për një kohë të gjatë, sekretarin që e zëvendëson, për të gjitha problemet që i dalin degës, qoftë për të orientuar punën e degës, ashtu dhe për të nxjerrë konkluzione e detyra për punën e Partisë në rreth.

Ministria e Punëve të Brendshme jep llogari në Byronë Politike, në Sekretariat, në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, në Kuvendin Popullor e në Presidiumin e tij dhe në Këshillin e Ministrave.

Organi i punëve të brendshme në rreth jep llogari në këshillin popullor të rrethit dhe në komitetin ekzekutiv të tij për zbulimin, parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë armiqsore e keqberëse në ekonomi, për sigurimin dhe ruajtjen e kufirit, për ruajtjen e rendit e të qetësisë, për zbatimin e ligjshmërisë socialiste, për sjelljet e marrëdhëniet e punonjësve me popullin, për zbatimin e detyrave të marra nga organet e pushtetit në rreth etj. Në këto analiza ruhet konspiracioni për çështjet e agjenturës, përpunimeve dhe formave e metodave të punës operative.

Kuadrot e sigurimit të ushtrisë japin llogari në organizatën-bazë, në byro e në komitetin e Partisë të njësisë për kryerjen e detyrave funksionale, pa dekonspiruar agjenturën, përpunimet dhe format e metodat e punës operative.

Kuadrot e sigurimit të ushtrisë, për kryerjen e detyrave të tyre operative, nuk varen nga komanda e repartit dhe të njësisë ku shërbejnë, por nga organet drejtuese të sigurimit, prej të cilave marrin urdhra e udhëzime.

Ministri i Mbrojtjes Popullore informohet pa

asnjë kufizim për gjithë veprimtarinë armiqsore e keqberëse që zhvillohet në ushtri.

Zëvendësministrat e Mbrojtjes Popullore informohen, sipas përkatësisë, për veprimtarinë armiqsore e keqberëse që zhvillohet në shkallë ushtrie, pa dekonspiruar agjenturën, përpunimet dhe format e metodat e punës operative.

Shefi i sigurimit të divizionit ose i njësisë të barabartë me të informon pa asnjë kufizim sekretarin e komitetit të Partisë të divizionit dhe, kur ky mungon për një kohë të gjatë, zëvendësin e tij, për të gjitha problemet që i dalin në repartet e nënrepartet e njësisë ku punon, të cilat duhet t'i dijë qoftë për të orientuar punën e degës, ashtu dhe për të nxjerrë konkluzione e detyra për punën e Partisë në njësi.

Shefi i sigurimit të brigadës dhe i regjimentit informon sekretarin e byrosë të Partisë të brigadës dhe të regjimentit për veprimtarinë armiqsore e keqberëse që zhvillohet në repartet e nënrepartet e njësisë, si dhe për personat që zhvillojnë këtë veprimtari, me përjashtim të rasteve kur përpunimi paraqet rëndësi të veçantë operative, kur personi që përpunohet është kuadër shef shtabi batalioni e lart dhe kur personi në përpunim ka lidhje armiqsore jashtë repartit.

Për këto raste sekretari i byrosë së Partisë të brigadës ose të regjimentit vihet në dijeni mbasi

të jetë marrë për këtë miratimi i sekretarit të komitetit të Partisë të divizionit ose i njësisë të barabartë me të dhe i shefit të sigurimit.

Kuadrot e sigurimit të ushtrisë zbatojnë si të gjithë ushtarakët rregulloret, urdhrat dhe udhëzimet e ministrit të Mbrojtjes Popullore.

III

Burimi kryesor i forcës së organeve të punëve të brendshme është populli. Patriotizmi dhe vigjilenca revolucionare e masave punonjëse duhet të përbëjnë bazën e informacionit dhe të luftës së organeve të punëve të brendshme për zbulimin, parandalimin dhe goditjen në kohë të veprimtarisë armiqsore e keqbërëse.

Organet e punëve të brendshme duhet të forcojnë vazhdimisht lidhjet e tyre me popullin, të mësojnë prej tij, të dëgjojnë zërin e masave dhe të kërkojnë ndihmën e tyre për realizimin e detyrave të përditshme. Asnjëherë dhe për asnjë arsye nuk lejohet që nën pretekstin e përdorimit të formave të mbyllura të punës operative, të mohohet apo nënvleftësohet vija e masave.

Kuadrot që merren me punë operative të luftojnë vazhdimisht për të ngritur vigjilencën e masave për zbulimin, parandalimin, dokumentimin

dhe goditjen në kohë të veprimtarisë armiqsore dhe keqbërëse.

Punonjësit e organeve të punëve të brendshme janë shërbëtorë të popullit. Veprimtaria e tyre duhet t'i nënshtrohet kontrollit të masave punonjëse. Nën udhëheqjen e Partisë organet e punëve të brendshme, sipas rastit, duhet të gjejnë vetë format e të krijojnë mundësi reale që masat punonjëse ta realizojnë këtë të drejtë, të kritikojnë të metat e dobësitë e mundshme të këtyre organeve, si dhe sjelljet e qëndrimet e papërshtatshme të ndonjë punonjësi të organeve të punëve të brendshme. Të zbatohen me kujdes të veçantë orientimet e Partisë mbi kontrollin punëtor-fshatar në organet e punëve të brendshme. Të forcohet dhënia llogari nga ana e organeve të punëve të brendshme para masës e para organeve të zgjedhura të pushtetit popullor.

IV

Organet e Sigurimit të Shtetit, si dhe sektorët operativë të Policisë Popullore (mbrojtjes së ekonomisë socialiste e i ndjekjes së krimeve), për realizimin e detyrave të tyre kanë të drejtë të ndërtojnë rrjetin sekret informativ dhe të organizojnë punën operative kudo që e lyp nevoja, duke përjashtuar:

a. Organizatat dhe organet e Partisë.
b. Aparatin e Presidiumit të Kuvendit Popullor, Prokurorinë e Përgjithshme, Gjykatën e Lartë, Hetuesinë e Përgjithshme, si dhe organet e tyre në rrethe.

c. Aparatin e Kryeministrisë, Komisionin e Planit të Shtetit, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe organet e saj, Ministrinë e Punëve të Jashtme, të Energjetikës, të Industrisë dhe Minierave, të Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore, të Arsimit dhe të Kulturës, të Bujqësisë, të Financave, të Tregtisë së Brendshme, të Tregtisë së Jashtme, të Komunikacioneve, të Ndërtimit, të Komunales, të Shëndetësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Postave e Telekomunikacioneve, si dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore.

ç. Këshillin e Përgjithshëm të Bashkimeve Profesionale, Këshillin e Përgjithshëm të Frontit Demokratik, Këshillin e Përgjithshëm të Bashkimit të Grave, Komitetin Qendror të Bashkimit të Rinisë të Punës të Shqipërisë, si dhe organet e tyre në rrethe.

V

Për të zbuluar, parandaluar, dokumentuar e goditur veprimtarinë e armiqve të jashtëm e të brendshëm të Republikës Popullore Socialiste të

Shqipërisë dhe të elementëve keqbërës, vetëm organet e Sigurimit të Shtetit dhe sektorët operativë të Policisë Popullore (i mbrojtjes së ekonomisë socialiste e i ndjekjes së krimeve) kanë të drejtë të ndërtojnë rrjetin sekret informativ të përbërë nga rezidentë, agjentë, informatorë dhe strehues.

Në rrjetin sekret informativ të Sigurimit të Shtetit, si dhe të sektorëve operativë të Policisë Popullore tërhiqen shtetas shqiptarë, shtetas të huaj dhe persona pa shtetësi.

Tërheqja në bashkëpunim sekret bëhet në baza patriotike, vullnetare e detyrimi dhe kurdoherë për qëllime të caktuara operative.

Tërheqja në bashkëpunim sekret me detyrim bëhet mbi bazën e të dhënave operative, kallzimeve ose dokumenteve të tjera të vërtetuara, që provojnë se kandidati ka kryer një vepër penale.

Tërheqja në bashkëpunim mbi bazë detyrimi bëhet në gjëndje të lirë ose arresti. Tërheqja në bashkëpunim sekret mbi bazë detyrimi në gjëndje të lirë bëhet nga organet e Sigurimit të Shtetit dhe sektorët operativë të Policisë Popullore në bazë të bashkëbisedimit të lirë me vetë personin.

Tërheqja mbi baza detyrimi në rastet kur vendoset të zbatohet masa e arrestimit sekret, bëhet me miratim të organeve udhëheqëse të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në këto raste nda-

limi për tërheqje bëhet brenda një afati prej 72 orësh.

Organet e Sigurimit të Shtetit, si dhe sektorët operativë të Policisë Popullore, kanë të drejtë të përdorin në rrjetin sekret informativ edhe anëtarë e kandidatë partie, por kjo kategori bashkëpunëtorësh, në kuadrin e përgjithshëm të rrjetit informativ të këtyre organeve, duhet të jetë e kufizuar. Ata kryesisht duhet të kryejnë detyrën e rezidentit e të strehuesit.

Në çdo rast, anëtarët ose kandidatët e Partisë që përdoren në rrjetin sekret informativ duhet të mos kenë funksione partie dhe, para se të tërhiqen në bashkëpunim, të merret miratimi i sekretarit të parë të komitetit të Partisë të rrethit, ndërsa në ushtri i sekretarit të komitetit të Partisë të divizionit ose njësisë të barabartë me të.

Për bashkëpunëtorët anëtarë e kandidatë partie nuk merret dokument (deklaratë) bashkëpunimi.

Ndalohet kategorikisht që bashkëpunëtorët anëtar apo kandidat partie t'u raportojë organeve të punëve të brendshme mbi çështjet që mëson e diskuton në organizatën-bazë të Partisë.

Ndalohet kategorikisht futja e bashkëpunëtorëve në veprime operative me detyra që janë në kundërshtim me vijën e Partisë, ligjshmërinë socialiste dhe me normat e moralit komunist.

Ndalohet kategorikisht takimi sekret vetëm nga një punonjës i organeve të punëve të brendshme me bashkëpunëtorë femra.

Puna operative e Sigurimit të Shtetit, si dhe e sektorëve operativë të Policisë Popullore, duhet të synojë kurdoherë për të zbuluar të vërtetën mbi veprimtarinë armiqsore dhe keqbërëse. Asnjëherë dhe për asnjë arsye nuk lejohet shtrembërimi, falsifikimi i fakteve dhe manipulimi i provave. Personat që kryejnë veprime të tilla dënohen penalisht.

Puna operative e Sigurimit të Shtetit, si dhe e sektorëve operativë të Policisë Popullore, është një veprimtari e fshehtë që përbën sekret shtetëror.

VI

Objekt i punës operative janë shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi që kryejnë, kanë kryer ose paraqesin dyshime se mund të zhvillojnë veprimtari armiqsore e keqbërëse kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Ndalohet të vihen në përpunim pa miratimin përkatës:

a. Anëtarët dhe kandidatët e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë,

anëtarët e Qeverisë dhe deputetët e Kuvendit Popullor.

b. Kuadrot e emërtesës së Byrosë Politike dhe të Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Kuadrot e emërtesës së Byrosë Politike ose të Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë mund të vihen në përpunim vetëm me miratimin e Sekretariatit ose të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë.

Anëtarët dhe kandidatët e Partisë vihen në përpunim pasi merret miratimi i sekretarit të parë të komitetit të Partisë të rrethit, ndërsa në ushtri, (për anëtarë e kandidatë partie dhe për oficerë) merret miratimi i sekretarit të komitetit të Partisë të divizionit apo të njësisë të barabartë me të.

Të dhënat për veprimtari armiqsore e keqberëse që dalin nga rrjeti sekret informativ për anëtarë e kandidatë partie (duke përjashtuar ata të pikës "a" e "b" të këtij kapitulli) merren, por me to nuk kryhet asnjë veprim pa marrë më parë miratimin e sekretarit të parë të komitetit të Partisë të rrethit dhe në ushtri të sekretarit të komitetit të Partisë të divizionit ose të njësisë të barabartë me të.

Kur dalin të dhëna nga rrjeti sekret informativ për personat që i përkasin pikës "a" e "b" të këtij kapitulli, ato nuk merren me shkrim, por

për përmbajtjen e tyre bëhet shënim operativ dhe informohen menjëherë sekretari i parë i komitetit të Partisë të rrethit (vetëm për personat që banojnë e punojnë në rreth) si dhe ministri i Punëve të Brendshme e nëpërmjet tyre Komiteti Qendror i Partisë.

Studimi dhe vlerësimi i të dhënave e i materialeve që shërbejnë si bazë për hapjen e përpunimit agjenturor të një anëtari apo kandidati partie, duhet bërë me shumë kujdes. Ato të verifikohen e dokumentohen me masa të shpejta operative.

VII

Në tërësinë e masave operative në drejtim të zbulimit, parandalimit, dokumentimit dhe goditjes së veprimtarisë armiqsore e keqberëse vetëm organet e punëve të brendshme kanë të drejtë të përdorin edhe këto lloje e mjete të punës operative:

1. Të bëjnë kontrollin sekret të korrespondencës post-telefon-telegrafike të të dënuarve, kur shihet e nevojshme edhe korrespondencën e të internuarve e të dëbuarve, personave në përpunim, si dhe çdo korrespondencë tjetër, kur ka të dhëna me përmbajtje armiqsore e keqberëse.

Ndalohet kontrolli i korrespondencës që nuk përfshihet në kategoritë e mësipërme.

Kontrolli postar i korrespondencës së jashtme bëhet i përgjithshëm. Ai përfshin kontrollin e të gjithë korrespondencës e të kolive që qarkullohen nëpërmjet kanaleve postare e doganore të vendit tonë me shtetet e huaja (letra e telegrame, biseda telefonike, pako, koliposta, telekse, shirita magnetikë, kasete, videokasete, shtypin e botimet e ndryshme).

Përrjashtohen nga kontrolli i korrespondencës së jashtme:

a. Organet e Partisë së Punës të Shqipërisë, Presidiumi i Kuvendit Popullor, Këshilli i Ministrave, Ministritë, Komisioni i Planit të Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Postave e Telekomunikacioneve, si dhe organet qendrore të organizatave të masave.

b. Anëtarët e kandidatët e Komitetit Qendror të Partisë, anëtarët e Qeverisë, deputetët e Kuvendit Popullor, sekretarët e parë të komiteteve të Partisë të rretheve e të divizioneve në ushtri ose të njësisive të barabarta me to, Prokurori i Përgjithshëm, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Kryetari i Hetuesisë së Përgjithshme dhe kryetarët e komiteteve ekzekutive të rretheve.

c. Shtetasit e huaj të ftuar si miq nga Partia, Presidiumi i Kuvendit Popullor dhe Qeveria.

ç. Posta diplomatike.

Kontrolli i shtypit dhe i botimeve që vijnë në

vendin tonë nga jashtë e anasjelltas të bëhet sipas rregullave të caktuara nga Komiteti Qendror i Partisë.

Gjatë kontrollit të korrespondencës, organet e punëve të brendshme kanë të drejtë të ndalojnë e të konfiskojnë korrespondencën me përmbajtje kundërrevolucionare ose të dyshimtë për veprimtari armiqsore.

Kontrolli i korrespondencës të bëhet pa lënë gjurmë e pa penguar shërbimin postar.

2. Të përdorin vëzhgimin sekret në drejtim të personave që janë në përpunim ose që dyshohen për veprimtari armiqsore e keqbërëse. Vëzhgimi nuk ndërpritet edhe kur objekti në vëzhgim takohet ose shoqërohet me persona të tjerë.

3. Të përdorin teknikën operative në drejtim të personave që janë në përpunim ose që dyshohen për veprimtari armiqsore e keqbërëse. Në procesin e përdorimit të teknikës operative veprimet të mos ndërpriten edhe kur në të futen persona të tjerë.

4. Të përdorin veprimet operative sekrete për zbulimin, dokumentimin dhe ndërprerjen e veprimtarisë armiqsore e keqbërëse.

5. Të përdorin vërtetimin biografik për interesa operative.

Gjatë realizimit të detyrave operative organet e punëve të brendshme përdorin fondin sekret (të veçantë).

VIII

Shifra shtetërore përpilohet, riprodhohet dhe shpërndahet vetëm nga Ministria e Punëve të Brendshme. Organi qendror shifror i Ministrisë së Punëve të Brendshme kontrollon administrimin, ruajtjen dhe përdorimin e shifrës shtetërore si brenda edhe jashtë vendit.

Për Komitetin Qendror të Partisë dhe organet e Partisë në rrethe, organi qendror shifror i Ministrisë së Punëve të Brendshme bën vetëm prodhimin e shifrës, ndërsa kontrolli për administrimin, ruajtjen dhe përdorimin e saj bëhet nga organi shifror pranë Komitetit Qendror të Partisë.

Për emërimin e kuadrove të shifrës në organet shtetërore, Ministria e Punëve të Brendshme jep pëlqimin e saj.

Organet e punëve të brendshme nuk kanë të drejtë të njihen me përmbajtjen e teksteve të shifruara që nuk i përkasin sektorit të punës së tyre.

IX

Shërbimi kriminalistik i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë drejtohet nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Gjatë procesit të punës operative për zbulimin, parandalimin dhe dokumentimin e veprimta-

risë armiqsore e keqbërëse edhe ky shërbim jep ndihmën e vet, duke përdorur mjete tekniko-shkencore bashkëkohore.

Organet e punëve të brendshme kërkojnë edhe ndihmën e ekspertëve të mjekësisë ligjore, psikiatrisë gjyqësore si dhe të specialiteteve të tjera të shkencave shoqërore dhe ekzakte.

Krahas detyrave për zbulimin dhe goditjen në kohë, në thellësi e në mënyrë të gjithanshme të çdo lloj veprimtarie armiqsore e keqbërëse, organet e punëve të brendshme duhet të bëjnë një punë të madhe edhe për parandalimin e krimeve, për shpëtimin e njerëzve që kanë hyrë në rrugë të gabuar e kanë rënë viktima të veprimtarisë armiqsore e keqbërëse, duke gjetur e përdorur për këtë qëllim forma e metoda të ndryshme pune.

Që të mund të realizojnë detyrat e ngarkuara nga Partia, punonjësit e organeve të punëve të brendshme duhet të karakterizohen nga një moral i lartë komunist, të jenë të thjeshtë e të palodhur, patriotë të zjarrtë, trima e të gatshëm për të sakrifikuar gjithçka për atdheun, të dashur me popullin, të rreptë e të pamëshirshëm me armikun.

Punonjësit e organeve të punëve të brend-

shme duhet të pajisen me një përgatitje të thellë ideologjike e politike dhe vigjilencë të lartë revolucionare. E gjithë puna e tyre duhet të përshkohet nga një partishmëri e thellë, të jenë punëtorë politikë e agjitorë të flaktë të vijës së Partisë me masat. Çdo çështje të punës së tyre ata duhet ta shikojnë gjithmonë në prizmin politik.

Gjithë urdhrat, udhëzimet dhe rregulloret që rregullojnë aspekte të veçanta të procesit të punës operative dalin në bazë dhe për zbatim të kësaj Platforme.

SEKRETARI I PARË I KOMITETIT QENDROR

TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

ENVER HOXHA d. v.